

## RELACION

Mbi

### RAPORTET E MONITORIMI TË VITIT 2019

Me ligjin nr.99 datë 3.12.2018 “Për Buxhetin e vitit 2019”, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i është miratuar buxheti fillestar për vitin 2019 prej 46.703.704.000 lekë, nga të cilat 4.554.080.000 lekë për shpenzime korrente dhe 42.149.624.000 lekë për shpenzime kapitale.

Me aktet normative, buxheti përfundimtar ka pësuar ndryshime (pakësime) duke arritur në vlerën 45.434.704.000 lekë, nga të cilat 4.554.080.000 lekë për shpenzime korrente dhe 40.080.624.000 lekë për shpenzime kapitale.

Detajimi i buxhetit për vitin 2019 është mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 2019-2021 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë dhe është realizuar sipas programeve buxhetore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimi i synuar, si dhe lidhjet midis politikave sektoriale dhe aktiviteteve nga ku janë përcaktuar dhe buxhetet për çdo program.

Për vitin 2019, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë administroi dhe menaxhoi fondet buxhetore sipas 11 programeve, si më poshtë :

1. Planifikim, Menaxhim, Administrim
2. Transporti Rrugor
3. Transporti Detar
4. Transporti Hekurudhor
5. Transporti Ajror
6. Furnizimi me Uje dhe Kanalizime
7. Menaxhimi i Mbetjeve Urbane
8. Mbështetje për Energjinë
9. Mbështetje për Burimet Natyrore
10. Mbështetje për Industrinë
11. Planifikimi Urban

Buxheti faktik për vitin 2019 është realizuar 39.799.096 mijë lekë kundrejt 46.145.828 lekë ose 86 %.

#### Monitorimi i shpenzimeve sipas programeve

##### **1. PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIMI**

Fondet buxhetore në këtë program parashikohen për funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative të Aparatit të Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjisë, rritjen e standardeve dhe performancës së punës me qëllim përmbushjen e objektivave që ka institucioni.

## SHPENZIMET KORRENTE

- *Fondi për paga dhe sigurime shoqërore*, plani i rishikuar 2019 prej 298.2 milion lekë është realizuar në vlerën 296.1 milion lekë ose 99%.
- *Shpenzimet operative*, plani i rishikuar 2019 prej 219 milion lekë është realizuar në vlerën 194.5 milion lekë ose 89%.
- *Transferrat korrente të huaja*, plani i rishikuar 2019 prej 28 milion lekë është realizuar në vlerën 21.1 milion lekë ose 76%.
- *Transferrat për Buxhetin Familjar dhe Individual*, plani i rishikuar 2019 prej 71 milion lekë është realizuar në vlerën 70.8 milion lekë ose 100%.

## SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Buxheti i vitit 2019, për investimet me financim të brendshëm, për këtë program është planifikuar në shumën 13 milion lekë dhe realizimi financiar është 12.8 milion lekë ose 99%.

Sipas projekteve ai paraqitet :

- “Rikonstrukcion në godinën nr.2, në ish-MZHU(kontratë shtesë)”, është planifikuar në vlerën 9.7 milion lekë dhe është realizuar për periudhën 12-mujore në masën 100%.
- Hartimi i projekt-zbatimit të objektit "Rikonstrukcion i ish godinës së drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Tiranë" është planifikuar në vlerën 1.9 milion lekë dhe realizimi financiar për periudhën 12-mujore është në masën 100%.
- “Mbikqyrje punimesh për rikonstrukcionin e godinës së ish-MZHU” është planifikuar në vlerën 300 mijë lekë dhe realizimi financiar për periudhën 12-mujore është në masën 100%.
- Asistencë teknike "Zhvillimi infrastrukturës digjitale rajonale" është planifikuar në vlerën 100 mijë lekë dhe nuk ka realizim financiar, pasi projekti nuk u arrit të implementohej.
- “Blerje paisje zyrash” është planifikuar në vlerën 966 mijë lekë dhe realizimi financiar për periudhën 12-mujore është në masën 100%.

## 2. TRANSPORTI RRUGOR

Bazuar në objektivin e përgjithshëm të Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016-2020, programi i transportit rrugor synon:

- Të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit dhe përveç kësaj;
- Të përmirësojë ndjeshëm qëndrueshmërinë, ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij më gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin;
- Programi i Transportit Rrugor mbulon me financim zgjerimin, rritjen e standardeve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, me synim krijimin e një transporti të qëndrueshëm

## SHPENZIMET KORRENTE

Plani i vitit 2019 prej 1,879,999,000 lekë, është realizuar në vlerën 1,765,920,000 lekë ose 94%. Konkretisht, zërat buxhetore të detajuar, paraqiten si më poshtë :

- Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore në shumën 180,180,000 lekë, është realizuar në shumën 160,229,000 lekë ose rreth 89%, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, Drejtorinë e Rajonit Verior Shkodër, Drejtorinë e Rajonit Qendror Tiranë, Drejtorinë e Rajonit Jugor Gjirokastrë dhe Institutin e Transportit.
- Shpenzimet operative, janë planifikuar shumën 1,699,090,000 lekë, dhe realizimi financiar është shumën 1,605,145,000 lekë, ose rreth 95 %.
- Shpenzimet e buxheteve familjare dhe individë, për vitin 2019, janë akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si fond i veçantë në këtë zë, plani 729,000 lekë dhe realizimi financiar 546,000 lekë ose 75%.

Detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2019, për kontratat e mirëmbajtjes të Autoritetit Rrugor Shqiptar, ishin në vlerën 765,977,778 lekë dhe me buxhetin e vitit 2019, u likujduan detyrimet e prapambetura në vlerën 386,090,377 lekë ose 50% të detyrimeve të kontratave të mirëmbajtjes.

Detyrimi i prapambetur, i krijuar në fund të vitit 2019 është 357,663,620 lekë, ku 293,424,869 lekë detyrime të prapambetura nga viti 2018, nga kontrata të përfunduara, si dhe fondi 64,238,751 lekë detyrime të krijuara gjatë vitit 2019.

## SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Buxhetime i këtij programi është në vlerën 15,124,100,000 lekë dhe realizimi financiar për vitin 2019, është në vlerën 15,097,086,000 lekë ose 99 %.

Në buxhetin e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, janë financuar projektet e kontratave koncesionare në shumën 4,489,553,000 lekë dhe realizimi financiar për vitin 2019, është 4,481,502,714 lekë, ose 99 % e planit e realizuar.

Projektet koncesionare të cilat kanë realizuar fondet buxhetore të vitit 2019, sipas modelit financiar të miratuar dhe kontrates efektive, janë :

- Projekti koncesionar për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe operimin e Rrugës së Arbrit, si dhe kontrata e supervizionit të punimeve të ndërtimit,
- Projekti për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot – Morinë, si dhe kontrata e supervizionit të punimeve të ndërtimit.

Gjithashtu, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, fondet e planifikuara për investimet me financim të brendshëm për vitin 2019, janë 10,625,547,000 lekë dhe realizimi financiar është 10,610,173,412 lekë ose 99,8% e planit e realizuar, ku janë mbështetur me fonde të gjitha kontratat në vazhdim, mbeshtetja buxhetore e zerave TVSh dhe Kosto Lokale, e projekteve me financim të huaj.

Detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2018, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, ishin në vlerën 2,547,679,738 lekë, ku me buxhetin e vitit 2019, u likujduan detyrime në vlerën 2,172,150,661 lekë ose 85 % të zërit investimeve direkte, vendimet gjyqësore të formës së prerë, studim projektive, supervizion punimesh, Tvsh, Kosto Lokale.

Autoriteti Rrugor Shqiptar, me fondet buxhetore të rialokuara gjate vitit 2019, ka likujduar detyrimet e prapambetura të cilat janë krijuar rishtazi gjatë vitit 2019, në vlerën 2,297,762,831 lekë. Në zbatim të Aktit Normativ nr.11, datë 24.12.2019, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, u pakësuan fondet në vlerën 1 milion lekë, për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Me buxhetin e vitit 2019 u financuan totalisht 18 projekte zbatimi, si më poshtë :

- 1- Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti 2 (dy viadukte), dublimi;
- 2- Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti 2 (dy viadukte), dublimi (shitesë punimesh);
- 3- Plotësim, rakordim, masa mbrojtëse dhe siguri rrugore në viaduktet e aksit Kukës-Morinë;
- 4- Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (seg Kth Saukut - Bregu i lumit), Loti 1;
- 5- Ndërtim i aksit rrugor Skrapar – Përmet, Loti 1;
- 6- Ndërtim i aksit rrugor Skrapar - Përmet Loti 1, (shitesë punimesh);
- 7- Rikonstruksion i aksit rrugor Ura e Gajdarit hyrja Sarandë;
- 8- Sistemim asfaltim e masa inxhinierike në Km.21+050, në rrugën Qafë Thanë Lin – Pogradec;
- 9- Sistemim asfaltim masa inxhinierike në Km.21+050, në rrugën Qafë Thanë Lin – Pogradec, shitesë punimesh;
- 10- Pjesa e mbetur e punimeve në segmentin Lin-Pogradec, km 4 deri 21;
- 11- Masa inxhinierike për stabilizimin e shembjes në Km.21+363÷ Km.21+468, në segmentin Lin – Pogradec;
- 12- Stabilizim i rrëshqitjes në aksin Tunel – Elbasan km 17.36- 17.46, segmenti 3, aksi Tiranë - Elbasan (Dalje tuneli i Krrabës km 15.20 - Elbasan km 27);
- 13- Studim projektim i aksit rrugor Gjirokastër - Libohovë - Poliçan – Zagori;
- 14- Studim projektim Plotësimi i By Pass Shkodër si pjesë e koridorit Veri-Jug dhe lidhja me qytetin;
- 15- Studim Projektim i Urave të Leklit, Dragotit, Ura e Vorës, Tapizës, Ura e Drojës, Zemblakë, rikonstruksioni i urës së Kaludhit dhe nyja në disnivel në Bushnesh dhe ura lidhëse e rrugëve Levan-Tepelenë me Dragot-Tepelenë);
- 16- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore, në akset e Rajonit Verior, Loti 1;
- 17- Implementi i sistemit të menaxhimit të trafikut (Vazhdimi) dhe instalimi i sensoreve pesh për aks;
- 18- Sistemi i menaxhimit të kontratave, inspektimi dhe raportimi;

Nga raporti i realizimit të produkteve dhe i shpenzimeve faktike të programit sipas produkteve, rezulton se:

Grupi i produktit "Ndërtim Rruge" i shprehur në sasi (km) për 12 mujorin e vitit 2019 është parashikuar 11.62 km dhe është realizuar ndaj planit vjetor përkatësisht 11.62 km dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt është planifikuar 6,507,407,000 lekë dhe është realizuar 6,501,667,000 lekë ose 100 % e planit.

Produktet e shprehur në terma sasiore (km) sipas tipeve të ndërtimit të rrugëve (tip A2 me katër korsi, A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim, B1' me dy korsi, C2 dhe me dy korsi), janë planifikuar për 12 mujorin e vitit 2019 konkretisht:

Për vitin 2019, janë planifikuar dhe realizuar :

PLANIFIKUAR	FINANCUAR
A2 - 0.17 km	0.17 km
A2 me standartet e reja - 0.29 km.	0 km
A2' - 7.05 km	7.05 km
B1' - 3.13 km	3.13 km
C2 - 1.27 km	1.27 km

Grupi i produktit "Rikonstruksion Rruge" i shprehur në sasi (km) për 12 mujorin e vitit 2019 është parashikuar 2.69 km dhe është realizuar 2.69 km ose 100% e shpenzimeve faktike për këtë produkt.

Shpenzimet e këtij grupi janë planifikuar për financimin e rrugëve Tip C2 me dy korsi. Produktet e shprehur në terma sasiore (km) sipas tipeve për rikonstruksionin e rrugëve (tip C2 & B' me dy korsi), janë planifikuar për 12 mujorin e vitit 2019 konkretisht:

PLANIFIKUAR	FINANCUAR
C2 - 2.69 km	2.69 km

Edhe për zërin "Rikonstruksion rruge" është akorduar fond për të gjithë kontratat në vazhdim.

Realizimi i produkteve dhe i shpenzimeve për 12-mujorin e vitit 2019, paraqitet :

#### Ndërtim rruge tip A2 me katër korsi (2x2):

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 346,601,000 lekë (5.3% ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge") dhe në sasi 0.17 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit, është në vlerën 346,591,000 lekë ose 100% e buxhetit të planifikuar.

Përfshihen në këtë grup rrugë me katër korsi dhe gjerësi 20-25 m, me disa objekte të rëndësishëm si:

- "Ndërtim rruga Kukës - Morinë Loti 2 (dy viadukte) dublimi"
- "Ndërtim rruga Kukës - Morinë Loti 2 (dy viadukte) dublimi (shitesë punimesh);
- "Plotësim, rakordim, masa mbrojtëse dhe siguri rrugore në viaduktet e aksit Kukës-Morinë";
- "Vendosja e mbikalimeve në aksin rrugor Thumanë - Milot dhe Kukës – Morinë";

#### Ndërtim rruge tip A me katër korsi (2x2) sipas Standarteve të Reja:

Për këtë grup produkti, janë planifikuar fonde në vlerën 4,186,000 lekë (0 % ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge") dhe në sasi 0 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit, janë në vlerën 4,176,000 leke (0 % ndaj planit vjetor "Grupi i produktit "Ndërtim Rruge") ose 100% e buxhetit të planifikuar për këtë grup produkti.

Përfshihen në këtë grup rruge:

- "Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 1, Loti 2, Loti 3";
- Studim projektim mbikalimi TEG;

- Studim projektim, rishikim i projektit për segmentin rrugor të vazhdimet të unazës së madhe Tiranë nga sheshi Shqiponja - Bulevardi i ri;

#### Ndërtim rruge tip A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 2,496,234,000 lekë (38 % ndaj planit të përgjithshëm vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge) dhe në sasi 7.05 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 2,496,233,000 lekë ose 100 % e buxhetit të planifikuar dhe në km janë realizuar 7.05 km ose 100 % e sasisë së planifikuar.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me katër korsit dhe gjërësi që varion nga 24-25 m, me disa objekte të rëndësishëm që janë në proces si:

- "Përfundim i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore nyja e Milotit";
- "Ndërtim i unazës së Jashtme Tiranë pjesa verilindore (seg Kth Saukut-Bregu i lumit) Loti 1, Loti 2, Loti 3";
- "Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2 , Loti 3";
- "Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 + shtesë punimesh dhe Loti 2";

#### Ndërtim rruge tip B1' me dy korsit:

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 1,695,580,000 lekë (26 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge") dhe në sasi 3.13 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është 1,695,568,000 lekë dhe në km janë realizuar 3.13 km ose 100 % e sasisë së planifikuar.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me dy korsit dhe gjërësi që varion nga 10-17 m, duke përmendur disa objekte të rëndësishme në të cilat punohet me ritme të parashikuara :

- "Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4, Loti 5, Loti 6";
- "Ndërtim rruga Milot - F. Krujë (dublimi i superstradës) Loti 3";

#### Ndërtim rruge tip C2 dhe C2' me dy korsit :

Për tipin e rrugës C2 janë planifikuar fonde në vlerën 1516,654,000 lekë ose 23 % ndaj planit vjetor, (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge") dhe në sasi 1.27 km.

Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2 është në vlerën 1,516,632,000 lekë dhe në sasi 1.27 km osae 100% e sasisë së planifikuar.

Janë përfshirë kryesisht tip rruge C2 me dy korsit dhe gjërësi që varion nga 7.5-10 m.

Po punohet normalisht në objektet që janë në proces:

- "Ndërtim By Pass Tepelenë Loti 1"
- "Ndërtim i aksit Skrapar-Përmet Loti 1+ shtesë punimesh"
- "Rikonstruksioni aksit rrugor ura e Gajdarit hyrja Sarandë"
- "Ndërtim mure mbajtës dhe pritës në segmentin rrugor Kuben – Vasije"

#### Rikonstruksion rruge tip C2 me dy korsit:

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 430,817,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit "Rikonstruksion Rruge) dhe në sasi 2.69 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 430,200,000 lekë ose 100 % e buxhetit të planifikuar të Grupit të produktit "Rikonstruksion Rruge". Përfshihen kryesisht (Sistemim Asfaltim) rrugë me gjërësi deri 8.5 metra tip C2.

Janë në proces ndërtimi disa objekte të rëndësishme si:

- "Sistemim asfaltim masa inxhinierike ne Km.21+050, në rrugën Qafë Thanë Lin-Pogradec + shtesë punimesh";
- "Sistemim asfaltim masa inxhinierike ne Km.21+050, ne rrugen Qafe Thane Lin-Pogradec+ Shtesë punimesh";
- "Pjesa e mbetur e punimeve në segmentin Lin-Pogradec, km 4 deri 21";
- "Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Elbasan- Banjë, Loti 3+ shtesë punimesh";

#### Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore:

Për këtë zë, në buxhetin e vitit 2019, ishin planifikuar fonde në vlerën 443,152,000 lekë, dhe realizimi financiar i shpenzimeve është 442,467,000 lekë ose 100% ndaj planit vjetor. Në këtë grup produkti, vlera e planifikuar ne sasi eshte 365.4 km dhe eshte realizuar ne sasi produkti 365.3 km.

Përfshihen objektet:

- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Rajonit Verior, Loti 1;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Rajonit Verior, Loti 1, vazhdimi;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Rajonit Qendror, Loti 2;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3, vazhdimi;
- Punime ndërtimi për eliminimin e pikave të zeza në rrugë ( bashkëfinancim IPA 2013, Siguria rrugore).
- 

Grupi i shpenzimeve për shpronësime dhe vendime gjyqësore, garanci objekti, ura, të tjera i detajuar paraqiten si më poshtë:

	PLANIFIKUAR	FINANCUAR
- Vendime gjyqësore	682,966,335 lekë	682,966,335 lekë ose 100% e buxhetit.
- Shpronësime	742,000.000 lekë	728,632,820 lekë ose 98% e buxhetit.

Gjatë vitit 2019, janë zbatuar edhe projektet :

- ✓ "Implementi i sistemit të menaxhimit të trafikut (vazhdimi) dhe instalimi i sensorëve pesh për aks", plani 28,259,760 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 28,259,760 lekë, ose 100%.
- ✓ "Sistemi i menaxhimit te kontratave, inspektimi dhe raportimi", plani 9,576,000 lekë, financimi 9,576,000 lekë, ose 100%.

- ✓ "Rikonstruksion godine (ARRSH dhe tre Drejtorite rajonale dhe blerje pajisje zyre) plani në vlerën 16,510,000 lekë, dhe realizimi financiar në shumën 16,253,880 lekë ose 99%.
- ✓ "Shpenzimet kapitale për TVSH dhe Kosto Lokale", së bashku janë planifikuar në vlerën 2,195,820,482 lekë dhe realizimi financiar për vitin 2019, është si më poshtë:
  - Kosto Lokale, plani 837,994,651 lekë dhe realizimi financiar 837,942,593 lekë , ose 100%
  - TVSH e Detyrim Doganor, plani 1,357,825,831 lekë dhe realizimi financiar 1,357,824,198 lekë ose 100%.

Në programin "Transportit Rrugor", përfshihet dhe Instituti i Transportit, i cili në buxhetin e vitit 2019, ka planifikuar fonde në zërat TVSH dhe Kosto Lokale, për projektet IPA, në të cilat ky institucion po i implementon, si më poshtë :

- Kosto Lokale, plani 7,600,000 lekë dhe realizimi financiar 4,632,859 lekë ose 61% e planit.
- TVSH e Detyrim Doganor, plani 1,400,000 lekë dhe realizimi financiar 777,463 lekë ose 55,5 % e planit e realizuar.

### **SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË HUAJ**

Financimit të huaj për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 7,348,132,000 lekë dhe është financuar vlera 6,533,038,000 lekë ose 90 %.

Në sasi në zërin ndërtim rrugësh Kategoria B, C dhe Kategori të ndryshme (mirëmbajtja), janë planifikuar 1376 km dhe janë realizuar 1376 km.

Realizimi i produkteve dhe shpenzimeve, për vitin 2019 paraqitet si më poshtë :

Për Tipin e rrugës B, janë planifikuar fonde në vlerën 3,759,849,000 lekë dhe realizimi në vlerën 3,838,194,000 lekë ose 102 % e buxhetit të planifikuar. Në sasi janë realizuar 25 km të këtij tipi rruge.

Për Tipin e rrugës C, janë planifikuar fonde në vlerën 574,130,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 652,579,000 lekë ose 114 % e buxhetit të planifikuar. Në sasi janë realizuar 18 km të këtij tipi rruge.

Për Tipin e rrugës Kategori të Ndryshme janë planifikuar fonde në vlerën 2,944,153,000 lekë dhe në sasi 1333 km. Realizimi i shpenzimeve për këtë tip rruge është 2,042,265,000 lekë ose rreth 69 % e planit. Në sasi janë realizuar 1334 km të këtij tipi rruge.

## **3. TRANSPORTI DETAR**

### **SHPENZIMET KORRENTE**

Fondet buxhetore të planifikuara për këtë program prej 99.030.000 lekë janë realizuar në shumën 93.579.000 lekë ose 94 %.



Janë përfshirë shpenzimet korrente për paga, sigurime shoqërore, mallra e shërbime, për punonjësit e administratës për Drejtorinë e Përgjithshme Detare për funksionimin dhe mbarëvajtjen e kësaj strukture.

#### **SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM**

Investimet me financim të brendshëm, janë planifikuar në shumën 100,000,000 lekë për vitin 2019 dhe realizimi financiar është në vlerën 47,425,000 lekë ose 47%.

Sipas projekteve ai paraqitet :

- “Rikonstrukcion i kalatës RORO në portin e Sarandës” plani i rishikuar është në vlerën 3,6 milion lekë dhe është realizuar për periudhën 12-mujore në masën 0%, vlerë e cila për shkak se nuk u miratua leja zhvillimore për rikonstrukcion nga Bashkia Sarandë.
- “Konservimi i ndërmarrjes së kontrollit të shfrytëzimit të mjeteve ujore Vau i Dejës” është planifikuar në vlerën 3 milion lekë dhe është realizuar për periudhën 12-mujore në masën 100%, vlerë e cila për shkak se fondet buxhetore paguhen paga dhe sigurime për punonjësit.
- “Ndërtimi i LRIT” plani i rishikuar është në vlerën 44,3 milion lekë dhe realizimi financiar për periudhën 12-mujore është në masën 100%.
- “Rikonstrukcion i kalatës lindore të mallrave në Portin e Vlorës” është planifikuar në vlerën 38 milion lekë dhe është realizuar për periudhën 12-mujore në masën 0%, vlerë e cila për shkak se nuk u realizuan procedurat e prokurimi brenda afateve ligjore.
- “Tvsh për projektin e Konektivitetit të Adriatikut Jugor” është planifikuar në vlerën 800 mijë lekë dhe realizimi financiar për periudhën 12-mujore është në masën 0%, vlerë e cila për shkak projekti do të filloj implementimin në vitin 2020.
- “Tvsh për projektin e asistence-teknike për monitorimin, komunikimi i kontrates sektoriale” është planifikuar në vlerën 200 mijë lekë dhe realizimi financiar për periudhën 12-mujore është në masën 26%.
- “Tvsh për projektin e rehabilitimit të kalatës së Portit Vlorë” është planifikuar në vlerën 10 milion lekë dhe realizimi financiar për periudhën 12-mujore është në masën 0%, vlerë e cila për shkak se janë pezulluar punimet nga kompania italiane për shkak të shpalljes së falimentimit të kompanisë e cila po zbatonte projektin.

#### **4. TRANSPORTI HEKURUDHOR**

Programi “Transporti Hekurudhor ” ka për qëllim Integrimin e Sistemit Hekurudhor Shqiptar me atë Rajonal dhe Evropian nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave zhvilluese në fushën e infrastrukturës dhe mjeteve të transportit hekurudhor

#### **SHPENZIMET KORRENTE**

Fondet buxhetore të planifikuara për këtë program prej 420.970.000 lekë janë realizuar në shumën 413.816 mijë leke ose 98 %.

Janë përfshirë shpenzimet korrente për paga, sigurime shoqërore, mallra e shërbime, për punonjësit e administratës së Inspektoriatit Hekurudhor për funksionimin dhe mbarëvajtjen e kësaj strukture në shumën 20.900 mijë lekë, të cilat janë realizuar në shumën 13.816 mijë lekë ose 66 % dhe subvencion për mbështetjen e hekurudhës, të cilat janë planifikuar 400 milion lekë dhe janë realizuar 400 milion lekë ose 100 %.

#### **SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM**

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë parashikuar në vlerën 153.500 mijë lekë dhe janë realizuar në shumë 144.491 mijë lekë ose 94 %

- Permiresimi i infrastruktures hekurudhore është realizuar në masën 91.138 mijë lekë, nga 97.446 mijë lekë të planifikuara ose 94 %.
- Rritja e disponibilitetit të mjeteve levizes është realizuar në masën 35.346 mijë lekë, nga 35.346 mijë lekë të planifikuara ose 100 %.

#### **SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË HUAJ**

Financimi i huaj i planifikuar për këtë program buxhetor prej 1.500.000 mijë lekë, është realizuar vetëm 86.496 mijë lekë për arsye të procedurave të prokurimeve mes MIE/HSH dhe BERZH-it. Ne pritje të firmosjes së kontratës me konsulentet e huaj.

### **5. TRANSPORTI AJROR**

#### **SHPENZIMET KORRENTE**

Në këtë program janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Organit Kombëtar të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture.

- *Paga dhe sigurime*, plani i rishikuar 2019 prej 9.810 mijë lekë është realizuar në vlerën 8.124 mijë lekë ose 83%.
- *Shpenzime operative*, plani i rishikuar 2019 prej 5.400 mijë lekë është realizuar në vlerën 2.124 mijë lekë ose 39%.

#### **SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM**

Buxheti i vitit 2019, për investimet me financim të brendshëm, për këtë program është planifikuar në shumën 19 milion lekë dhe nuk ka realizim financiar.

Në këtë program buxhetor janë përfshirë investime të nevojshme për Organin Kombëtar të Investigimit të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore. Procedurat dhe rolin e autoritetit kontraktor në lidhje me zërat e investimeve kryhen nga ky intucion në vlerën 1 milion lekë, që lidhen me pajisje për inspektorët e investigimeve ajrore si dhe të ambienteve të stafit, respektivisht në vlerat si më poshtë:

- |  |     |
|--|-----|
| - Rikonstrukcion, riparim dhe sistemim i ambienteve të OKIAA | 800 |
| - Blerje e paisjeve dhe instrumentave pune për investigime   | 200 |

Këto investime të planifikuara për vitin 2019, nuk u realizuan për shkak të procedurave të prokurimit nga ana e OKIIA-s.

Në këtë program buxhetor gjithashtu janë përfshirë Shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e Kontratës Koncesionare/PPP "Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit".

Për vitin 2019 gjithashtu është planifikuar Shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e Kontratës Koncesionare/PPP "Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit", në vlerën 18 milion lekë. Lidhur me këtë projekt, referuar procedurës së përzgjedhjes së inxhinierit të pavarur të Aeroportit të Kukësit, ka përfunduar përlllogaritja e fondit limit dhe procedura e prokurimit për përzgjedhjen e inxhinierit të pavarur. Aktualisht nuk ka shpenzime faktike të realizuara për produktin "Shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e Kontrates Koncesionare/PPP "Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit".

## 6. FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME

### SHPENZIMET KORRENTE

Fondet buxhetore të planifikuara për këtë program prej 478.785 mijë lekë janë realizuar në shumën 475.859 mijë lekë ose 99 %.

Në këtë program janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Agjencisë së Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së mbetjeve, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture si dhe subvencione për ndërmarrjet/sha. ujësjellës kanalizime.

- *Fondi për paga dhe sigurime shoqërore*, plani prej 51.100 mijë lekë është realizuar në vlerën 48.766 mijë lekë ose 95%.
- *Shpenzime operative*, plani prej 19.700 mijë lekë është realizuar në vlerën 19.700 mijë lekë ose 100%.
- *Subvencionet* për ndërmarrjet dhe shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve, plani prej 400.000 mijë lekë është realizuar në vlerën 399.648 mijë lekë ose 100%.

### SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Buxheti i vitit 2019, për investimet me financim të brendshëm, për këtë program është planifikuar në shumën 4.432.000 mijë lekë dhe realizimi financiar është 4.140.724 mijë lekë ose 93%.

- Investimet buxhetore për rezultatin A/I: Ujësjellës i ri

Për investimet në këtë kategori produktesh plani i rishikuar i vitit 2019 është në vlerën 1,419,701 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi në vlerën 1,333,289 mijë lekë ose rreth 94%.

- Investimet buxhetore për rezultatin A/II: Rikonstruksion Ujësjellësi

Për investimet në këtë kategori produktesh plani i rishikuar i vitit 2019 është në vlerën 868,022 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi në vlerën 821,975 mijë lekë, ose 95%.

- Investimet buxhetore për rezultatin A/III: Kanalizimi I ri

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2019 janë planifikuar 594,191 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi 539,835 mijë lekë.

- Investimet buxhetore për rezultatin A/IV:Rikonstruksion KUZ

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2019 janë planifikuar 55,696 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi 54,975 mijë lekë, ose 99%.

- Investimet buxhetore për rezultatin A/V: Konsulencë

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2019 janë planifikuar 817,833 mijë lekë, në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi 753,629 mijë lekë, ose 92 %.

#### SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË HUAJ

Investimet me financim të huaj janë planifikuar 5,220,000 mijë lekë dhe janë financuar 4,097,756 mijë lekë ose 78.5% të planit të akorduar.

Realizimi sipas produkteve për objektet me Financim të Huaj:

- Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/I: Ujësjiellës i ri

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2019 janë planifikuar 3,780,000 mijë lekë, nga të cilat për periudhën raportuese janë realizuar 3,338,446 mijë lekë ose 88%.

- Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/II: Kanalizimi i ri

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2019 janë planifikuar 1,606,557 mijë lekë, nga të cilat për periudhën raportuese janë realizuar 1,381,084 mijë lekë ose 86%.

- Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/III: Impianti i Trajtimit të Ujrave të Zeza

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2019 janë planifikuar 410,000 mijë lekë nga të cilat për periudhën raportuese janë realizuar 14,338 mijë lekë ose 3% .

- Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/IV: Konsulencë

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2019 janë planifikuar 400,000 mijë lekë, nga të cilat për periudhën raportuese janë realizuar 400,000 mijë lekë ose 100 %.

## 7. MBETJET URBANE

Në buxhetin e vitit 2019, për këtë program buxhetor, ishin planifikuar dhe janë realizuar:

1. Për projektin “Administrimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë, masa shoqëruese Faza e dytë”, ishte planifikuar financim i huaj me vlerë 30,000,000 lekë dhe mbështetja buxhetore me TVSH 19,815,000 lekë. Nga monitorimi i produktit për vitin 2019, rezulton se janë disbursuar nga financimi i huaj 36,191,000 lekë dhe nga financimi i brendshëm janë disbursuar 9,536,000 lekë.  
Sqarojmë se ka patur tejkalim të disbursimit të financimit të huaj nga donatori ( Grant i KfW) përtej planit.
2. Për projektin “Administrimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë, Faza e dytë”, nuk ishin parashikuar fonde për financimin e huaj, pasi mendohej se do të përfundonte në vitin 2018. Problematikë, gjatë zbatimit të projektit, ka qenë kundërshtimi i ndërtimit të stacionit të transferimit të mbetjeve në Pogradec nga banorët e zonës. Ky projekt, ishte parashikuar të përfundonte brenda vitit 2018, por është shtyrë me marrëveshje të nënshkruar me KfW dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Ishin planifikuar detyrime për TVSH në vlerën 37,000,000 dhe u realizuan 18,090,000 lekë ose 49%.
3. Financimi i produktit “Venddepozitimi i Bushatit i ndërtuar (faza II)”, ishte planifikuar në vlerën 20,000,000 lekë, dhe rezulton realizimi i buxhetit në vlerën 19,562,000 lekë. Zbatimi i kontratës ndiqet nga Bashkia Vau i Dejës.
4. Financimi i produktit për “Sistemin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun e Beratit”, ishte planifikuar financim i huaj me vlerë 80.000.000 lekë dhe 15,000,000 lekë TVSH dhe janë realizuar 62,346,000 lekë ose 78% financim i huaj dhe 9,470,000 lekë TVSH ose 63%.
5. Financimi i produktit për “Sistemin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun e Vlorës”, ishte planifikuar financim i huaj me vlerë 400.000.000 lekë, nga granti dhe 190,000,000 lekë, nga kredia dhe është realizuar 149,225,000 lekë, nga granti dhe 22,805,000 lekë nga kredia. Ishte planifikuar financim i brendshëm 16,125,000 lekë tvsh dhe është realizuar 16,155,000 lekë ose 100%.
6. Financimi i produktit për “Impiantin e prodhimit të energjise nga mbetjet në Fier (Inceneratori i Fierit)”, ishte parashikuar 752,772,000 lekë dhe është realizuar 752,770,224 lekë. Disbursimet vazhdojnë sipas kontratës.
7. Financimi i produktit për “Impiantin e prodhimit të energjise nga mbetjet në Elbasan (Inceneratori i Elbasanit)”, ishte parashikuar 661,500,000 lekë dhe është realizuar 581,935,000 lekë. Disbursimet vazhdojnë sipas kontratës.
8. Financimi i produktit për mallra dhe shërbime “Impianti i prodhimit të energjise nga mbetjet në Tiranë (Inceneratori i Tiranës)”, ishte parashikuar 500,000,000 lekë dhe është realizuar 500,000,000 lekë. Disbursimet vazhdojnë sipas kontratës dhe zbatohet nga Bashkia Tiranë.

## 8. MBËSHËTETJE PËR ENERGIJË

Mbështetja e politikës dhe prioriteteve të Qeverisë për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë nëpërmjet garantimit dhe furnizimit me burime të sigurta energjetike me kosto minimale. Pjesë e rëndësishme është edhe ruajtja e mjedisit nga efektet negative për shkak të zhvillimit të sektorit energjetik, diversifikimi i furnizimit me burime energjetike dhe integrimi në rrjetet energjetike rajonale dhe Europiane, duke nxitur investimet në këtë sektor. Nxitja dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme si faktor për rritjen e sigurisë së furnizimit. Në terma konkrete ky program parashikon të arrijë furnizimin e pandërprerë të konsumatorit me energji elektrike. Në vitin 2020 do të rritet përdorimi i energjisë së rinovuar me 38% kundrejt vitit 2009. Në vitin 2020 do të rritet eficaenca e energjisë me 6.5% referuar vitit 2009.

Për vitin 2019, objektivat e këtij programi buxhetor janë:

1. Komisionimi, marja në dorëzim dhe oponenca e HEC-ve të vogla, si dhe hartimi i bilancit energjetik bazuar në përpunimin e informacionit sipas standarteve dhe rregulloreve të statistikës së energjisë të BE-së.
2. Studim për hartimin e rregullores për verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë për biokarburantet, si dhe rishikimi i kushteve dhe normave teknike në aktivitetet dhe infrastrukturën e furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure .
3. Auditimi dhe vendosja e skemës detyruese për eficaencën e energjisë në 5-8 konsumatorët e mëdhenj publike sipas ligjit 124/2015 për EE dhe Funksionimi i Agjencisë për Eficacencën e Energjisë sipas ligjit 124/2015.
4. Krijimi i kushteve për ndërtimin e një infrastrukture ligjore të sigurtë për energjitë bërthamore.

Ky program buxhetor, përgjithësisht përfshin fondet buxhetore në mbështetje të politikave për fushën e energjisë, si atë elektroenergjetike, energjisë së rinovueshme dhe hidrokarburet për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë. Referuar të dhënave mbi shpenzimet faktike, rezulton se për vitin 2019 shpenzimet në total për këtë program janë realizuar në masën 61%.

Nëpërmjet këtij programi financohen institucionet si AKOB, AKBN si dhe Agjencia e Eficacencës së Energjisë.

### SHPENZIMET KORRENTE

Shpenzimet korrente, plani vjetor është 93,930,000 lekë dhe realizimi financiar vjetor 37,546,000 lekë, ose rreth 40 %.

Realizimi i ulët i shpenzimeve lidhet me moskryerjen e shpenzimeve të arbitrazhit në disa çështje që MIE ka me këtë organizëm në fushën e energjisë.

### SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Shpenzimet me financim të brendshëm, plani vjetor është 1,697,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 1,632,347,000 lekë, ose 96%.

Në projektet me financim i brendshëm, janë përfshirë projekte studimore në fushën energjetike që implementohen nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për :

- Kontrollin e realizimit të investimeve për ndërtimin e HEC-ve me konçension sipas kontratave përkatëse dhe marrja në dorëzim e tyre, sipas programit të zhvillimit të projekteve të vlerësuar nga Oponenca Teknike - Raporte për Oponencën Teknike;
- Hartimin e bilancit energjetik bazuar në përpunimin e informacionit sipas standarteve dhe rregulloreve të statistikës së energjisë të BE-së - Bilanc Energjetik;
- Rregulloren për verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë për biokarburantet - Pakete ligjore dhe rregullatore;
- Rishikimin e kushteve dhe normave teknike në aktivitetet dhe impiantet e prodhimit, depozitimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre;
- Studim mbi ndikimin në mjedis nga aktivitetit në sektorin hidrokarbur;
- Studim mbi fuqizimin e infrastrukturës së furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure;
- Ripërcaktimin e rezervave të naftës dhe gazit në përputhje me standartet e BE-së duke dhënë rekomandime konkrete për burime energjetike me bazë hidrokarbure

Projektet e mësipërme janë realizuar në masën 100%.

Gjithashtu në këtë program financohen me TVSH dhe Kosto lokale edhe disa projekte me financim të huaj që MIE menaxhon në sektorin energjetik.

## 9. MBËSHTETJE PËR BURIMET NATYRORE

Në buxhetin e vitit 2019, për programin "Mbështetje për Burimet Natyrore", janë planifikuar fonde për mbështetjen e politikave në fushën e menaxhimit të burimeve natyrore, që synojnë jo vetëm zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar, por dhe rritjen e transparencës në shfrytëzimin racional të burimeve natyrore.

### SHPENZIMET KORRENTE

Shpenzimet korrente, plani vjetor është 160,561,000 lekë dhe realizimi financiar vjetor 142,953,503 lekë, ose rreth 89 % e planit e realizuar.

Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, janë planifikuar fonde për shpenzimet korrente si më poshtë :

- Paga për punonjësit, janë planifikuar 110,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 99,161,000 lekë, ose rreth 90 %.
- Sigurime shoqërore, janë planifikuar 21,500,000 lekë dhe realizimi financiar është 21,500,000 lekë, ose rreth 100 %.
- Shpenzimet operative, janë planifikuar 28,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 26,229,000 lekë, ose rreth 93,6 %.
- Për vitin 2019, është planifikuar fondi i veçantë në vlerën 1,061,000 lekë dhe realizimi financiar është 1,058,000 leke ose rreth 99,7 %, e zbatuar sipas kriterëve të VKM nr.929, date 17.11.2010, i ndryshuar.

### SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Shpenzimet me financim të brendshëm, plani vjetor është 128,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 126,206,000 lekë, ose rreth 98,5 % e planit e realizuar.

Në projektet me financim i brendshëm, janë përfshirë projekte studimore në fushën minerare, të monitorimit të subjekteve minerare të licensuar në fushën e shfrytëzimit minerar, studimeve gjeologjike, gjeofizike, hidrologjike. Këto projekte implementohen nga Agjencia Kombëtare e

Burimeve Natyrore, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, dhe ndërmarrjet në konservim Albbakër sh.a, Albkrom sh.a, Albminierat sh.a.

Objektivat e këtij programi realizohen nga :

- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, janë 6 projekte, ku plani i buxhetit është 35,935,000 lekë dhe realizimi financiar 35,935,000 lekë ose 100 % e planit e realizuar.
- Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, janë planifikuar 4 projekte investimi me vlerë 20,870,000 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 20,832,000 lekë ose rreth 99,8% e planit e realizuar.
- Mbyllja dhe monitorimi i fenomeneve të post shfrytëzimit minierar, po zbatohet nëpërmjet shoqërive "Abminiera", "Albkrom", "Albbakër". Për vitin 2019, për këto shoqëri janë planifikuar 32,985,000 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 32,985,000 lekë ose rreth 100 % e planit e realizuar. Me fondet buxhetore të vitit 2019, këto shoqëri kanë shlyer detyrimet e prapambetura, paga, sigurime shoqërore.
- Rritja e cilësisë në mirëqeverisjen e industrisë nxjerrëse, nëpërmjet rritjes së transparencës në industri, realizohet nëpërmjet Sekretariatit për Nismën e Transparencës në Industrinë Nxjerrëse, me projektin "Raport mbi industrinë nxjerrëse në Shqipëri". Për vitin 2019, për këtë institucion, plani prej 10,900,000 lekë, është realizuar në vlerën 10,611,000 lekë ose rreth 97,3 % e planit e realizuar.

## 10. MBËSHTETJE PËR INDUSTRIJË

Në buxhetin e vitit 2019, për programin "Mbështetje për Industrinë", janë planifikuar fonde për mbështetjen e politikave në rritjen e nivelit të sigurisë së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të produkteve/pajisjeve/instalimeve, reduktimit të aksidenteve në punë, eliminimit të rrezikut të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme gjëndje në kushte të pa sigurta depozitimi dhe ruajtje në magazinat apo ambientet e ish ndërmarrjeve dhe subjekteve publike në varësi, në dy landfillet në të cilat janë depozituar mbetjet e rrezikshme nën administrimin e MIE dhe në QGTKRR Elbasan, likuidimin dhe mbylljen e ish ndërmarrjeve industriale në varësi duke realizuar transferimin e plotë të aseteve të mbetura nga administrim shtetëror në administrim privat.

### SHPENZIMET KORRENTE

Shpenzimet korrente, plani vjetor është 254,769,000 lekë dhe realizimi financiar vjetor 241,607,000 lekë, ose rreth 94 % e planit e realizuar.

Nëpërmjet këtij programi financohen institucionet si Agjencia Kombëtare për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe Qendrën e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan.

Për këto institucione, janë planifikuar fonde për shpenzimet korrente si më poshtë :

- Fonde për paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit, janë planifikuar 171,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 168,025,000 lekë, ose rreth 98 %.
- Shpenzimet operative, janë planifikuar 83,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 73,188,000 lekë, ose 88 %.



- Për vitin 2019, është planifikuar fondi i veçantë në vlerën 769,000 lekë dhe realizimi financiar është 393,000 leke ose 51 %, e zbatuar sipas kritereve të VKM nr.929, datë 17.11.2010, i ndryshuar.

## **SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM**

Shpenzimet me financim të brendshëm, plani vjetor është 90,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 87,228,000 lekë, ose 97 %.

Nëpërmjet këtyre fondeve financohen institucionet si AKSEM, ISHTI, QGTKRR dhe ndërmarjet në konservim Azotiku Fier, Prodhim Mobilje Tiranë, Uzina e Baktir Rubik, NPÇ Elbasan, Kombinati Energjitik Elbasan, Prodhim Kabllo Shkodër .

Realizimin e buxhetit për vitin 2019 në nivel produkti, është si më poshtë:

- “Paisje shpëtuese dhe emergjence”, fondi i programuar 1.515.000 lekë, është realizuar 1.514.000 lekë, ose 100%.
- “Monitorim i Landfilleve të mbetjeve të rrezikshme Fier dhe Vlorë”, fondi i programuar 960.000 lekë është realizuar 960.000 lekë, ose 100%.
- “Rikonstruksion i ish Uzinës së Bakrit Rubik”, fondi i programuar 24 milion lekë, është realizuar 24 milion lekë, ose 100%.
- “Ndërtim i murit Rrethues” në ish Uzinën e Azotikut Fier”, fondi i programuar 6 milion lekë, është realizuar 6 milion lekë, ose 100%.
- “Blerje paisje kompjuterike dhe sigurim me kamera”, fondi i programuar 1 milion lekë, është realizuar 782.000 lekë, ose 78%.
- “Blerje paisje dedegtuse”, fondi i programuar 2.207.000 lekë, është realizuar 2.206.000 lekë ose 100%.
- “Paisje zyre”, është realizuar 100% sipas planifikimit.
- “Konservim i ish ndërmarrjeve industriale ”, nga 46.453.000 lekë të programuara për vitin 2019, janë realizuar 45.865.000 lekë ose 99%.
- “Blerje mjet transporti Vinc pirun”, fondi i planifikuar 2.640.000 lekë është realizuar 100%.

## **11. PLANIFIKIMI URBAN**

Në buxhetin e vitit 2019, për programin "Planifikimi Urban", janë planifikuar fonde për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit në çdo nivel dhe në integrim me çdo sektor, rigjenerimin urban dhe krijimin e modeleve të reja të zhvillimit të territorit, hartimin e politikave dhe projekteve në fushën e mbetjeve të ngurta urbane.

### **SHPENZIMET KORRENTE**

Shpenzimet korrente, plani vjetor është 99,720,000 lekë dhe realizimi financiar vjetor 65,220,000 lekë, ose rreth 67 % e planit e realizuar.

Nëpërmjet këtij programi financohet Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit.

Për këtë institucion, janë planifikuar fonde për shpenzimet korrente si më poshtë :

- Fonde për paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit, janë planifikuar 21.500,000 lekë dhe realizimi financiar është 17,401,000 lekë, ose rreth 86 %.
- Shpenzimet operative, janë planifikuar 8,100,000 lekë dhe realizimi financiar është 6,790,000 lekë, ose 84 %.
- Për vitin 2019, u alokua fondi prej 40.000.000 lekë në zbatim të VKM nr. date dhe realizimi financiar është 40.000,000 leke ose 100%.

#### SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Shpenzimet me financim të brendshëm, plani vjetor është 190,620,000 lekë dhe realizimi financiar është 80,031,000 lekë, ose rreth 67 %.

Për programin “Planifikim Urban” janë parashikuar, në total, rreth 190.62 milion lekë, 10 milionë për AQTN-në, dhe rreth 180.62 milionë për projektet që ndjek Aparati i MIE.

Zbatimi i projekteve për vitin 2019:

- ✓ Projekti “Hartimi i Planeve të Përgjithshme Vendore”, ka përfunduar afati i hartimit sipas kontatave, pritet të sillen Raportet e Përputhshmërisë nga grupi i punës pranë AKPT, për të vijuar me likujdimet sipas fazave.
- ✓ Projekti “Rizhvillimi i zonës Tushemisht-Drilon pranë liqenit të Ohrit”, për arsye mos dakortësimi të Termave të Referencës me AADF (Fondi Amerikano- Shqiptar i Zhvillimit), fondet e projektit u përdoren për projekte të tjera.
- ✓ Kanë përfunduar projektet “Pajisje informatike të blera nga institucionet e varësisë”, “Projektzbatim për zgjerime dhe shtesë kati institucion varesie AQTN”, “TVSH për projektin e "KFW" si dhe projekti “Shpronësime për bashkitë Vlorë, Shkodër dhe Roskovec”.
- ✓ Projekti “Pajisje për skeleri dhe rafte arkivore”, është kryer prokurim i përqëndruar në Ministrinë e Brendshme, është në proces të zbatimit të kontratës.
- ✓ Projekti “TVSH për Zhvillimi i Integruar dhe i Qëndrueshëm i zonave bregdetare, GIZ”, për të cilin ka përfunduar kontrata dhe do të likujdohet fatura e fundit me fondet buxhetore të vitit 2020.
- ✓ Për projektin “Projekte pilote për rikualifikimin e blloqeve urbane”, është lidhur kontrata e cila do të zbatohet në vitin 2020.
- ✓ Për projektin “Sistemi i Integruar për informatizimin e Manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, fondet e planifikuara për vitin 2019 u pezulluan. Me kërkesë të AKSH-it, ky projekt do të vijojë në vitin 2020.
- ✓ Për projektin “Përshtatja dhe adaptimi i eurocodeve 5, 9 dhe 6 (pjesa 3) dhe 7(pjesa 3)”, është lidhur kontrata dhe do të vijojë në vitin 2020.

## SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË HUAJ

Investimet me financim të huaj, për vitin 2019, janë planifikuar në rreth 220 milionë lekë dhe janë realizuar në rreth 32.795 milionë lekë ose rreth 15%.

- ✓ Për projektin “Zhvillimi i integruar dhe i qëndrueshëm i zonës bregdetare, GIZ” janë parashikuar 16.8 milionë lekë dhe janë realizuar rreth 9.6 milionë lekë. Qeveria Gjermane nuk lëvront fonde direkt për sistemin buxhetor shqiptar, por shërbime në natyrë, për të cilat pagesat bëhen direkt nga llogaritë e donatorit. Projekti ka përfunduar në Shkurt të 2019.
- ✓ Për projektin “Programi i Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë”, për vitin 2019, janë planifikuar në rreth 203 milionë lekë. Ky projekt ka kaluar tek *Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)*.